



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

(Nr. _____ datë _____)

PËR

**PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË PËRDORIMIT TË KULLOTAVE DHE
LIVADHEVE PËR KULLOTJE OSE KOSITJE, PËR VEPRIMTARI
SHOQËRORE, SHËNDETËSORE, SPORTIVE E TURISTIKE DHE PËR
PRODHIMIN E ENERGJISË SË RINOVUESHME**

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës, të pikës 1 të nenit 15 dhe pikës 5, të nenit 17, të ligjit nr.9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullosor”, i ndryshuar, me propozim e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotjen e bagëtive ose për kositje të barit dhe për veprimtari shoqërore, shëndetësore, sportive e turistike si dhe për prodhimin e energjisë së rinovueshme, sipas përcaktimeve të këtij vendimi dhe shtojcave që i bashkëlidhen dhe janë pjesë përbërëse e tij.
2. Tarifat për dhënien në përdorim të kullotave e livadheve për kullotjen e bagëtive ose për kositjen e barit, janë sipas shtojcës nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Tarifat për dhënien në përdorim të kullotave dhe livadheve për veprimtari shoqërore, shëndetësore, sportive e turistike, janë sipas shtojcës nr.2, bashkëlidhur këtij vendimi.
4. Tarifat për dhënien në përdorim të kullotave dhe livadheve për prodhimin e energjisë së rinovueshme, janë sipas shtojcës nr.3, bashkëlidhur këtij vendimi.
5. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Pyjeve dhe njësitë e vetqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.
6. Vendimi nr.632, datë 11.6.2009 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje dhe kositje”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

SHTOJCA NR. 1

Tarifat për dhënie në përdorim të kullotave e livadheve për kullotjen e bagëtive ose për kositjen e barit

Kullotje		Lloji i bagëtive	Tipi i kullotës	
			Dimërore lek/krerë	Verore lek/krerë
1		Dhën	200	200
2		Dhi	250	250
3		Gjedh	1000	1000
4		Njëthundrakë	1200	1200
Kositje bari			Dimërore lek/m ²	Verore lek/m ²
				2
Ndërtime			Dimërore lek/m ² /vit	Verore lek m ² /vit
1	Qendër stani e rrethuar		100	100
2	Qendër përpunim bulmeti		150	150
3	Ngrehinë banimi për barinjtë		50	50
4	Objekte ndihmëse për barinjtë		150	150

SHTOJCA NR. 2

Tarifat për dhënie në përdorim të kullotave dhe livadheve për veprimtari shoqërore, shëndetësore, sportive e turistike

Aktiviteti	Tarifa lek/ha/vit		
	Për 1 vit	2-5 vite	6-10 vite
Ndërtime agroturistike	100 000	80 000	65 000
Veprimtari sportive	140 000	100 000	85 000
Veprimtari shlodhëse dhe kampingje	100 000	85 000	65 000

SHTOJCA NR. 3

Tarifat për dhënie në përdorim të kullotave dhe livadheve për prodhimin e energjisë së rinovueshme

Aktiviteti	Sipërfaqja (ha)	Kohëzgjatja (vite)	Tarifat (lekë/vit)
Park fotovoltaik	Deri në 10	Deri në 10	192 000
		Mbi 10	173 000
	Mbi 10	Deri në 10	156 000
		Mbi 10	132 000
Vendosje aerogjenratorë	Deri në 10	Deri në 10	120 000
		Mbi 10	100 000
	Mbi 10	Deri në 10	90 000
		Mbi 10	70 000